



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE DHE NDRIÇIMIT PUBLIK

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Data: 10.10.2022

Drejtuar: “POWER INDUSTRIES” sh.p.k, me NUIS L51706022H, me adresë: Tirane Vore PICAR Tiranë, Vorë, Picar, Zona Kadastrale, Nr.3974, Volumi 5, Faqe 143, Sipërfaqe Totale 2610 m².

* * *

Procedura e prokurimit: E hapur, marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 mujor.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-39133-08-17-2022

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje zgara dhe puseta” me afat lëvrimi nga lidhja e kontratës /kontratave deri në plotësimin e nevojave të autoritetit kontraktor sipas kërkesës, në bazë të marrëveshjes kuadër, me fond limit: 34.497.400 (tridhjetë e katër milion e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e katërqind) lekë pa TVSH.

Publikimet e mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike Datë 22.08.2022, Numri 114.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. Operatori ekonomik "POWER INDUSTRIES" sh.p.k, me NUIS L51706022H, me adresë: Tirane Vore PICAR Tiranë, Vorë, Picar, Zona Kadastrale,Nr.3974, Volumi 5, Faqe 143, Sipërfaqe Totale 2610 m2, dhe me ofertë ekonomike 32,986,001 (tridhjetë e dy milion e nentëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e një) lekë pa tvsh.
2. Operatori ekonomik "SAHORA" shpk me NUIS L91703022T me adresë Tiranë, Rruga Violeta Manushi, Nr. Pasurie 6/426, Zona Kadastrale 8170 dhe me ofertë 33,990,000 (tridhjetë e tre milion e nentëqind e nentëdhjetë mijë) lekë pa tvsh.

Është skualifikuar Operatori ekonomik i mëposhtëm:

"SAHORA" shpk me NUIS L91703022T me adresë Tiranë, Rruga Violeta Manushi, Nr. Pasurie 6/426, Zona Kadastrale 8170.

Arsyet e skualifikimit janë:

1. Nuk i plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim.

Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 2.1.a të kriterëve të veçanta të kualifikimit ku parashikohet se: *"Ofertuesi duhet të paraqesë: a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8" pasi nga dokumentacioni i paraqitur nga O.E në këtë deklaratë nuk është plotësuar pjesa 2, Shkaqet e përjashtimit, a DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-"*

Operatori ekonomik nuk ka plotësuar saktë të dhënat e nevojshme, në lidhje me seksionin "Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5- vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së", pasi O.E nuk ka deklaruar të dhënat për të gjithë Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik. Me saktësisht operatori ekonomik është vetdeklaruar, që nuk është i dënuar, vetëm për administratorin e shoqërisë por nuk është vetdeklaruar për ortakun, sipas të dhënave të marra në Ekstraktin e Regjistrimit Tregtar të subjektit, arsye skualifikimi kjo e konfirmuar edhe në vendimin e KPP 821/2022 me Ankimues: Operatori ekonomik "R*****L" SHPK dhe Autoriteti Kontraktor: Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik Tirane, ku është konfirmuar detyrimi i

operatoreve të vetdeklarojne që të gjithë personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk janë të dënuar.

2. Nuk përmbush piken 1.1.1 për Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

“Çertifikatë ISO 9001-2015 ose ekuivalent (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë)“, duke qene se nuk ka paraqitur asnjë dokument për përmbushjen e këtij kriteri.

Nuk përmbush piken 2.2.2 për Kapacitetin ekonomik dhe financiar:

” Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019,2020,2021, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor,organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”,, duke qene se nuk ka paraqitur bilancet e kerkuara.

Nuk përmbush piken 2.3.1 te kapacitetit teknik:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate”, duke qene se nuk ka paraqitur asnje dokument për vertetimin e këtij kriteri.

Nuk përmbush pikat 2.3.1, 2.3.2, 2.3.3, 2.3.4, 2.3.5, 2.3.6, 2.3.7, duke qene se operatori ekonomik nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi, katalog apo skede teknike, fletë analize apo raport testimi per produktet e kërkuara, mostra te produkteve dhe mjete qe ka në dispozicion.

Nuk përmbush kriterin 2.3.3 të kriterëve të veçanta të kualifikimit “Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog dhe/ose skedë teknike për mallrat objekt prokurimi, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë mallrat që do të ofrohen në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike e kërkuara.”

Operatori ekonomik “SAHORA” shpk, nuk ka paraqitur asnje dokument, skedë teknike apo katalog, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë mallrat që do të ofrohen apo qe të konfirmohet pajtueshmëria me specifikimet teknike të kërkuara.

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatori ekonomik i mëposhtëm është identifikuar si i suksesshëm:

1. Operatori ekonomik: “POWER INDUSTRIES” sh.p.k, me NUIS L51706022H, dhe me ofertë ekonomike 32,986,001 (tridhjetë e dy milion e nentëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e një) lekë pa tvsh.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Herion Rrapaj